

Më 10 tetor 2017 Mustafa Grainca u emërua Zëvendësministër i Financave i Republikës së Kosovës.

Funksione tjera të cilat i ka ushtruar Mustafa Grainca para marrjes së mandatit të zëvendësministrit të Financave janë:

Më 24 dhjetor 2013 , certifikohet si Anëtar i Kuvendit të Komunës së Ferizajt, si dhe emërohet anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa në KK Ferizaj, deri më 22.10.2017.

Në periudhën 14.09.2014 deri më 05.01.2016, koordinator i degës së Kolegjit UBT- Ferizaj dhe i angazhuar si staf akademik në këtë kolegji.

Më 18.01.2010 e deri më 24.12.2013 , ka ushtruar detyrën si *Drejtor i Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit* në komunën e Ferizajt , ku në mandatin e tij si funksion bazë kishte;

- hartimin e politikave buxhetore e financiare në kuadër të komunës së Ferizajt, ,përgjegjës për hartimin e buxhetit komunal, si dhe;
- udhëheqës i njësisë komunale për zhvillim ekonomik;
- udhëheqës i ekipit komunal për dhënien e tokës komunale në shfrytëzim për investitor të brendshëm e të jashtëm;
- udhëheqës i komisionit komunal për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me Partneritetin Publiko Privat;
- koordinator i aktiviteteve lidhur me aplikimin e komunës së Ferizajt në fondet e BE-së, si Eured 1 dhe Eured 2, nëpërmjet AZHR – lindje;
- udhëheqës i ekipit komunal për hartimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik 2015-2020.

Në periudhën 2003-2007 , ka punuar si drejtor financiar në ndërmarrjen private "Eurokos" shpk-Çagllavicë, Prishtinë.

Aktualisht është, pronar i kompanisë ndërtimore "Idea Invest" shpk - Ferizaj.

Zëvendësministri Mustafa Grainca është i lindur më 18.09.1974 në fshatin Cërnillë, Komuna e Ferizajt.

Jeton në Ferizaj me bashkëshorten e tij Arbërien dhe kanë katër fëmijë: Erletën, Erëzën, Blinin dhe Blondin.